

Kuvendi miraton një akt normativ, tetë projektligje dhe tetë projektvendime

Datë 23/12/2020

Mbledhja e fundit për këtë vit e sesionit plenar dhe e parafundit e kësaj legjislature vijoi me miratimin e një akti normativ plenare “Për një shtesë në ligjin nr 7703 dt. 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; 8 projektligje dhe miratimin e 8 projektvendimeve.

Në drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, u zhvillua sot mbledhja e fundit e sesionit plenar të parafundit të kësaj legjislature. Seanca e sotme u hap me raportimin e përgjithshëm nga ana e ministres së Shtetit për marrëdhëniet me parlamentin, znj. Elisa Spiropali, mbi veprimtarinë vjetore të institucioneve të pavarura. Më tej, seanca vijoi me shqyrtimin dhe miratimin e 1 akti normativ, 8 projektligjeve dhe 8 projektvendimeve.

Akti normativ i miratuar ishte “Për një shtesë në ligjin nr 7703 dt. 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Tetë projektligjet e miratuara nga seanca e sotme ishin:

1. “Për prokurimin publik”;
2. “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”;

3. “Për disa ndryshime në ligjin nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar”;

4. “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9179, dt. 29.1.2040, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar”;

5. “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, dt. 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar”;

6. “Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar sipas ligjit nr. 8685, dt. 9.11.2000, “Për trajtim të veçantë të personave që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”;

7. “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, dt. 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar””;

8. “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”.

Akti normativ i miratuar, “Për një shtesë në ligjin nr 7703 dt. 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, i cili kishte për qëllim dhënien e një ndihme, me karakter të përhershëm për familjen e personit që humb jetën aksidentalisht si rezultat i veprimeve të një punonjësi të organeve ligjzbatuese gjatë ushtrimit të detyrës, duke i përqëndruar diskutimet parlamentare te rasti i fundit i 25-vjeçarit të vrarë nga një punonjës i Policisë së Shtetit, u miratua me 99 vota pro, 5 kundër dhe 2 abstenim.

Projektligji, “Për prokurimin publik”, që sipas prezantimit nga folësit e shumicës parlamentare synonte përmirësimin e kuadrit rregullator të prokurimit publik, përmes reflektimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të ndryshme nga Komisioni Evropian, Banka Botërore, OECD, etj, duke synuar lehtësimin e procesit prokurues për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, mori 91 vota pro, 6 kundër dhe 9 abstenim.

Pesë projektligje të tjera, sillnin ndryshime ose shtesa të caktuara në ligjet e ekzistuese, u miratuan përkatësisht nga seanca plenare si vijon:

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” mori 93 vota pro, 7 kundër dhe 6 abstenim;

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar” mori 95 vota pro, 7 kundër dhe 4 abstenim;

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9179, dt. 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar” u miratua me 97 vota pro dhe 9 kundër;

“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, dt. 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar” u votua me 92 vota pro, 9 kundër dhe 4 abstenim;

“Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, dt. 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar” u miratua me 91 vota pro, 8 kundër dhe 5 abstenim.

Projektligji “Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar sipas ligjit nr. 8685, dt. 9.11.2000, “Për trajtim të veçantë të personave që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”, nismë e deputetit Ilir Beqja, për qëllim ka dhënien zgjidhje të problematikës me ish-punonjësit e nëntokës, të cilët figurojnë debitor ndaj fondeve të sigurimeve për arsye se gjatë trajtimit financiar me karakter social, kanë marrë paga si persona të punësuar ose vetëpunësuar. Në përfundim të diskutimeve ky projektligj mori 101 vota pro, 4 kundër dhe 1 abstenim.

Projektligji “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, gjithashtu nismë e deputetit Ilir Beqja, synon njohjen si periudhë sigurimi nga sigurimet shoqërore të periudhave të punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat në Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH nuk është dorëzuar dokumentacion i plotë për vjetërsinë. Në përfundim të diskutimeve, ky projektligj u miratua me 99 vota pro, 5 kundër dhe 2 abstenime.

Tetë projektvendimet e miratuara nga seanca e sotme plenare ishin:

1. “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, të organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar” (94 vota pro, 5 kundër dhe 5 abstenim),
2. “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, e organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” të ndryshuar” (92 vota pro, 6 kundër dhe 8 abstenim),
3. “Për strukturën, organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës së zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale” (94 vota pro, 9 kundër dhe 3 abstenim);

4. “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (94 vota pro, 6 kundër dhe 6 abstenim);

5.”Për zgjedhjen e Këshillit të Lartë Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”, nga ku znj. Violeta Nikleka Staka mori 92 vota pro; ;

6. “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë” (95 vota pro, 5 kundër dhe 6 abstenim);

7. “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së”, nga ku znj. Evgjëni Bashari mori 100 vota pro dhe

8. “Për zgjedhjen e 3 anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit Shqiptar”, votim në të cilin z. Ilir Keko mori 96 vota pro, z. Dionis Papadimitri mori 96 vota pro dhe z. Genc Përmeti, mori 96 vota pro.

Votimi i projektvendimi “Për emërimin e një anëtari të Bordit të AMF-së, që do të mbajë funksionin e kryetarit të Bordit”, më kërkesë të kryetarit të grupit parlamentar të PS-së, u shty për në seancat e ardhshme. Seanca, votoi edhe një here, për shkak të një parregullsie në seancën paraardhëse, amendamentet për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, dt. 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, ndryshime të cilat morën 91 vota pro, 9 kundër dhe 5 abstenim.

Në vijim të masave protokollare anti-Kovid, edhe sot seanca u zhvillua në kushte të posaçme.